



Butonat e  
volumit

Butoni i  
energjisë

|  
Porta USB e tipit C



Redmi 13C

Udhëzuesi i përdorimit të shpejtë

## Ju falënderojmë që zgjodhët Redmi 13C

Mbani shtypur butonin e energjisë për të ndezur pajisjen.

Ndriqni udhëzimet në ekran për të konfiguruar pajisjen.

Për më shumë informacion vizitoni faqen tonë të internetit:

[www.mi.com/global/service/userguide](http://www.mi.com/global/service/userguide)

### Rreth kartës SIM:

Mos futni karta SIM jo standarde në fole të kartës SIM. Ato mund të dëmtojnë fole të kartës SIM. PARALAJMËRIM: Mos e zbrërtheni këtë pajisje.

### WEEE



Për asgjësimin e sigurt të këtij produkti duhen ndërmarrë masa kujdesi të posaçme. Ky shënim tregon se ky produkt nuk duhet hedhur me mbeturinat e tjera shtëpiake në BE.

Për të parandaluar dëmtimin e mjedisit ose të shëndetit të njeriut nga hedhja e papërshtatshme e mbeturinave dhe për të nxitur ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve materiale, ju lutemi të kryeni riciklim të përgjegjshëm.

Për të ricikluar në mënyrë të sigurt pajisjen tuaj, përdorni sistemet e kthimit dhe të grumbullimit ose kontaktini me shitësin ku keni blerë në fillim pajisjen.

### KUJDES

RREZIK SHPËRTHIMI NËSE BATERIA ZËVENDËSOHET ME NJË LLOJ TË PASAKTË.

HIDHNI BATERITË E PËRDORURA NË PËRPUTHJE ME UDHËZIMET.



Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të dëgjimit, mos dëgjoni me vull të lartë për periudha të gjata.

Informacione dhe masa kujdesi shtesë për sigurinë mund të gjenden në lidhjen e mëposhtme: [www.mi.com/en/certification](http://www.mi.com/en/certification)

### Informacione të rëndësishme për sigurinë

Përpara përdorimit të pajisjes lexoni të gjitha informacionet e mëposhtme të sigurisë:

- Përdorimi i kabllove, i karikuesve ose i baterive të paautorizuara mund të shkaktojë zjarr, shpërthim, goditje elektrike, të paraqesë rreziqe të tjera ose të dëmtojë pajisjen.
- Temperatura e funksionimit e kësaj pajisjeje është 0°C deri në 40°C. Përdorimi i pajisjes në një mjedis jashtë këtij diapazoni mund të dëmtojë pajisjen.
- Nëse pajisja ofrohet me bateri të integruar, mos tentoni ta ndërroni vetë baterinë, në mënyrë që të shmangni dëmtimin e baterisë ose të pajisjes.
- Karikojeni pajisjen vetëm me kabllon dhe karikuesin e përfshirë ose të autorizuar. Përdorni vetëm aksesoret të autorizuar që janë të përputhshëm me pajisjen tuaj.
- Pasi karikimi të përfundojë, shkëputni karikuesin edhe nga pajisja, edhe nga priza elektrike. Mos e karikoni pajisjen për më shumë se 12 orë.
- Bateria duhet ricikluar ose asgjësuar e diferencuar nga mbeturinat shtëpiake. Trajtimi i gabuar i baterive mund të shkaktojë zjarr ose shpërthim. Asgjësoni ose ricikloni pajisjen, baterinë dhe aksesoret e saj në përputhje me rregulloret lokale.
- Mos e zbrërtheni, mos e goditni, mos e copëtoni ose mos e digjini baterinë. Nëse bateria duket e deformuar ose e dëmtuar, ndaloni menjëherë përdorimin e saj.
  - Mos e lidhni baterinë shkurt, pasi ky veprim mund të shkaktojë mbinxehje, djegie ose lëndim tjetër.
  - Mos e vendosni baterinë në ambient me temperaturë të lartë.
  - Mbinxehja mund të shkaktojë shpërthim.
  - Mos e zbrërtheni, mos e goditni ose mos e copëtoni baterinë, pasi ky veprim mund të shkaktojë rrjedhjen, mbinxehjen ose shpërthimin e baterisë.
  - Mos e digjini baterinë, pasi ky veprim mund të shkaktojë zjarr ose shpërthim.
- Përdoruesi nuk duhet ta heqë ose ta modifikojë baterinë. Heqja ose riparimi i baterisë duhet kryer vetëm nga një qendër riparimi e autorizuar nga prodhuesi.
- Mbajeni pajisjen të thatë.
- Mos u përipiqi ta riparoni vetë pajisjen. Nëse ndonjë pjesë e pajisjes nuk funksionon si duhet, kontaktini me mbështetjen për klientin të "Mi" ose dërgojeni pajisjen te një qendër riparimi të autorizuar.
- Lidhni pajisjet e tjera në përputhje me manualin e tyre të udhëzimeve. Mos lidhni pajisje të tjera të papajtueshme me këtë pajisje.
- Për ushqyesit AC/DC, priza elektrike duhet të jetë e instaluar afër pajisjes dhe të jetë lehtësisht e arritshme.



### Masat e kujdesit për sigurinë

- Ndriqni të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme që kufizojnë përdorimin e telefonave celularë në rrethana dhe në ambiente të veçanta.
- Mos e përdorni telefonin në pikat e karburantit ose në ambiente të tjera me atmosferë shpërthyes ose potencialisht shpërthyes, duke përfshirë vendet e mbushjes me karburant, hapësirat nën kuverta në anije, mjediset e transferimit ose të ruajtjes së lëndëve djegëse apo kimikateve ose në vende ku ajri mund të përmbajë kimikate ose grimca të tilla si kokrriza, pluhur ose pluhura metalikë. Zbatoni të gjitha tabelat e vendosura për fikjen e pajisjeve me valë, të tilla si telefonin celular ose pajisjet e tjera radio. Fikni telefonin celular ose pajisjet me valë kur jeni në një zonë shpërthimesh apo në vende ku kërkohet që të fikni "radiot dhënëse-marrëse" ose "pajisjet elektronike", për të parandaluar rreziqet e mundshme.
- Mos e përdorni telefonin në sallat e operimit në spital, në dhomat e urgjencës ose në ambientet e reanimacionit. Veproni gjithmonë në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e spitaleve dhe të qendrave shëndetësore. Nëse keni pajisje mjekësore, konsultohuni me mjekun tuaj dhe me prodhuesin e pajisjes për të përcaktuar nëse telefoni mund të ndërhyjë në funksionimin e pajisjes. Për të shmangur interferencën e mundshme të një stimulusi kardiak, ruani gjithmonë një distancë prej 15 cm midis telefonit celular dhe stimulusit kardiak. Kjo mund të arrihet duke e përdorur telefonin në veshin në anën e kundërt me stimulusin kardiak dhe duke mos e mbajtur telefonin në xhepin në kraharor. Për të shmangur interferencën me aparatat mjekësore, mos e përdorni telefonin pranë aparatit ndihmës të dëgjimit, implanteve kokleare ose pranë pajisjeve të tjera të ngjashme.
- Zbatoni të gjitha rregulloret e sigurisë në avion dhe fikni telefonin në bordin e avionit, kur kërkohet diçka e tillë.
- Kur jeni duke drejtuar një mjet, përdoreni telefonin në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse të qarkullimit rrugor.

- Për të shmangur goditjen nga rrufeja, mos e përdorni telefonin jashtë në mot me vetëtimë.
- Mos e përdorni telefonin për të bërë telefonata kur ai është duke u karikuar.
- Mos e përdorni telefonin në vende me lagështi të lartë, si për shembull në banjë. Ky veprim mund të rezultojë në goditje elektrike, lëndim, zjarr dhe dëmtim të karikuesit.

## Deklarata për sigurinë

Përditësoni sistemin operativ të telefonit duke përdorur veçorinë e integruar të përditësimit të softuerit ose vizitoni një nga pikat tona të autorizuar të shërbimit. Përditësimi i softuerit me anë të mënyrave të tjera mund të dëmtojë pajisjen ose të rezultojë në humbjen e të dhënave, në probleme sigurie dhe në rreziqe të tjera.

## Rregulloret e Bashkimit Evropian

### Deklarata e konformitetit me RED



Xiaomi Communications Co., Ltd., me këtë dokument deklaron se ky telefon celular dixhital GSM / GPRS / EDGE / UMTS / LTE me Bluetooth dhe Wi-Fi 23108RN04Y është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/BE "Për pajisjet radio" (RED). Teksti i plotë i deklaratës EU të konformitetit disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: [www.mi.com/en/certification](http://www.mi.com/en/certification)

### Informacioni për ekspozimin RF (SAR)

Kjo pajisje është në përputhje me kufijtë e shkallës së përthithjes specifike të energjisë (SAR) për ekspozimin e popullatës së përgjithshme/të pakontrolluar (lokalizuar në 10 gram SAR për kokën dhe trupin, kufiri: 2,0 W/kg) të specifikuar në Rekomandimin e Këshillit 1999/519/KE, Udhëzuesin e ICNIRP dhe të RED (Direktiva 2014/53/BE).

Gjatë testimit të SAR, kjo pajisje është caktuar që të transmetojë në nivelin më të lartë të certifikuar të fuqisë në të gjithë brezat e testuar të frekuencës dhe është vendosur në pozicione që simulojnë ekspozimin RF gjatë përdorimit në kokë pa asnjë ndarje dhe pranë trupit me një ndarje 5 mm.

Pajtueshmëria e SAR për përdorimin në trup bazohet në një distancë ndarjeje prej 5 mm midis njësive dhe trupit të njeriut. Kjo pajisje duhet mbajtur të paktën 5 mm larg trupit për të garantuar që niveli i ekspozimit RF të jetë në pajtim me nivelin e raportuar ose më i ulët se ai. Kur e mbani pajisjen pranë trupit duhet përdorur një kapëse për rripin e mesit ose një këllëf mbajtës, i cili nuk përmban pjesë metalike dhe mundëson ruajtjen e një ndarjeje të paktën 5 mm midis pajisjes dhe trupit. Pajtueshmëria me ekspozimin RF nuk është testuar ose nuk është certifikuar me ndonjë aksesor që përmban metal dhe mbahet në trup, dhe përdorimi i një aksesori të tillë duhet evituar.

### Informacioni për certifikimin (SAR më i lartë)

Kufiri SAR 10 g: 2,0 W/Kg,

Vlera e SAR: Koka: 0,980 W/Kg, Trupi: 0,986 W/Kg (5 mm distancë).

### Informacioni ligjor

Kjo pajisje mund të përdoret në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Ndëqni rregulloret kombëtare dhe lokale në vendet ku përdoret pajisja.

Kjo pajisje është e kufizuar për përdorim të brendshëm vetëm kur funksionon në intervalin e frekuencës 5250 deri në 5350 MHz në: AT, BE, BG, HR, CY, CZ, DK, EE, FI, FR, DE, EL, HU, IE, IT, LV, LT, LU, MT, NL, PL, PT, RO, SK, SI, ES, SE, UK (NI), IS, LI, NO, CH, TR

Lidhja Wi-Fi (duke përfshirë brezat e frekuencës Wi-Fi, standardet Wi-Fi dhe veçori të tjera të ratifikuara në specifikimet e Standardit IEEE 802.11) mund të ndryshojë në bazë të disponueshmërisë rajonale dhe mbështetjes së rrjetit lokal. Funkzioni mund të shtohet nëpërmjet OTA, atëherë dhe aty ku është e vlefshme.

Kufizimet në brezin 2,4 GHz:

Norvegji: Ky nënseksion nuk zbatohet për zonën gjeografike brenda një rrezeje prej 20 km nga qendra e Ny-Ålesund.

Sigurohuni që karikuesit e përdorur janë në pajtim me rregulloret në fuqi të shtetit dhe me standardet ndërkombëtare dhe rajonale të sigurisë.

### Brezat e frekuencës dhe fuqia

Ky telefon celular ofron brezat e mëposhtëm të frekuencave vetëm në zonat e BE-së dhe fuqinë maksimale të radio-frekuencave si më poshtë:

GSM 900: 35,5 dBm

GSM 1800: 32,5 dBm

Brezi WCDMA 1/8: 25,7 dBm

Brezi LTE 1/3/7/8/20/28/38/40/41: 25,7 dBm

Bluetooth: 20 dBm

Brezi 2,4 GHz i Wi-Fi: 20 dBm

Wi-Fi 5 GHz: 5150 deri në 5250 MHz: 23 dBm, 5250 deri në 5350 MHz: 20 dBm, 5470 deri në 5725 MHz:

20 dBm, 5725 deri në 5850 MHz: 14 dBm

NFC: 13,56 MHz < 42 dBuA/m në 10 m

### Etiketa elektronike

Kjo pajisje ka një etiketë elektronike për informacionet e certifikimit.

Për ta hapur atë, shkoni te Settings > About phone > Certification, ose hapni Settings dhe shkruani "Certification" në shiritin e kërkimit.

Modeli: 23108RN04Y

2310 tregon se ky produkt do të hidhet në treg pas muajit tetor 2023.

Modeli: MDY-09-EW/MDY-14-EQ

Për më shumë informacion mbi përshtatësin, vizitoni faqen tonë të internetit:

[www.mi.com/global/service/userguide](http://www.mi.com/global/service/userguide)

## Mohimi i përgjegjësishë

Ky udhëzues i përdorimit të shpejtë është publikuar nga Xìao mi ose një kompani bijë lokale e tij. Xìao mi mund të kryejë në çdo kohë dhe pa asnjë njoftim përmirësime dhe ndryshime në këtë udhëzues, që janë të detyruara si pasojë e gabimeve tipografike, të pasaktësive të informacionit aktual apo si rezultat i përmirësimit në programe dhe/ose pajisje. Sidoqoftë, këto ndryshime do të përfshihen në botimet e reja online të udhëzuesit të përdorimit të shpejtë (për detajet vizitoni [www.mi.com/global/service/userguide](http://www.mi.com/global/service/userguide)). Të gjitha fotot janë vetëm për qëllime ilustrimi dhe mund të mos pasqyrojnë saktësisht pajisjen aktuale.